



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12, pika c, nenit 17, pika f, nenit 40 al. 2, pika a dhe g, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L- 040, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenit 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L- 049, nenit 15 paragrafi 1, të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060, dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit me 01 Nr.569/1, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30 Janar 2015, miraton këtë:

R R E G U L L O R E

PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT

Neni 1

Qëllimi

- 1.1 Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, përcaktimin e lartësisë së tarifës së taksës për mbeturina, administrimin financiar, ripërdorimi i komponentëve të përdorshme nga mbeturinat, parandalimi i ndikimeve negative në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
- 1.2 Kjo rregullore ka për qëllim krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave, dhe të krijoj bazë juridike me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe ngritjen e nivelit të shërbimeve.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo draft rregullore definon minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e riciklimit dhe përcaktimin e taksës për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor që është nën juridiksionin e Komunës.

Neni 3

Përkufizimet dhe shkurtesat

MMN – Menaxhimi i Mbeturinave të ngurta;

Prodhuksi (Gjeneruesi) i mbeturinës - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon apo prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para - procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;

Mbeturina - substancë apo objekt që prodhuksi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh;

Mbeturina komunale - mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë;

Qendër grumbulluese - kuptojmë sipërfaqen tokësore të caktuar nga Komuna për trajtimin e mbeturinave.

Person - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave;

Vend deponim - kuptojmë vendin për shkatërrimin apo asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme ku hidhen, ngjishen dhe mbulohen mbeturinat.

Kompostimi - trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushtet e kontrolluara;

Largimi publik i mbeturinave – kuptojmë procesin e mbledhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave.

Dorëzim – kuptojmë nxjerrjen dhe hedhjen e mbeturinave nga prodhuesit në vendet e mbledhjes së mbeturinave.

Deponi - vend i caktuar dhe i rregulluar për mbeturina ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

Mbeturina inerte - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar.

Neni 4

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave

- 4.1** Personi i licencuar për mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, mbledh dhe grumbullon mbeturinat prej prodhuesve dhe zotëruesit dhe i transporton deri te objekti në të cilin bëhet menaxhimi i mbeturinave.

4.2 Mbeturinat e rrezikshme paraprakisht klasifikohen sipas llojeve, mblidhen, grumbullohen dhe transportohen.

4.3 Nëse ndotja ndodhë gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthej në gjendjen të mëparshme.

Neni 5

Përgjegjësia e Komunës mbi Menaxhimin e Mbeturinave

5.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.

5.2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.

5.3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

5.4 Formimi i sektorit mbi menaxhimin e mbeturinave, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike

5.4.1. Sektori mbi menaxhimin e mbeturinave, monitoron dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave,

5.4.2. Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.

5.4.3. Promovimi për minimizimin e mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj).

5.4.4. Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik - pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e MMN-së.(Menaxhimi i Mbeturinave të Ngurta)

5.4.5. Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.

5.4.6. Faturimi i taksës mbi mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja.

5.4.7. Përpilimi i raporteve, mbi menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të taksës mbi mbeturinat.

5.5 Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të taksapaguesve për mbeturina.

5.6 Taksa për MMN-në, caktohet nga ana e Kuvendit të Komunës.

5.7 Dorëzimi i Raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për MMN-në çdo 31 Mars të vitit pasues.

5.8 Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte optimale për veprimin dhe operimin e operatorëve publik dhe privat.

Neni 6

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave PKMM

6.1 Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë në pajtim me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave i nxjerr nga Ministria përkatëse (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) sipas nenit 10 të ligjit përkatës.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave

7.1 Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasjeje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave,

7.2 Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar.

7.3 Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit të KMM-së.

7.4 Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme).

7.5 Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj taksën e shërbimit.

7.6 Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër.

7.7 Ndërmarrjet prodhuese, shërbyese - hoteliere të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës së Rahovecit t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 8

Llojet dhe Klasifikimi i mbeturinave

Në funksion të kësaj Rregulloreje mbeturinat ndahen:

1. Mbeturinat e ngurta Komunale
2. Mbeturinat Komerciale
3. Mbeturinat Industriale
4. Mbeturinat Spitalore

1. Mbeturina e ngurta Komunale janë:

- a. **Mbeturina Komunale** quhen mbeturinat nga amvisëritë, dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë;
- b. **Mbeturina inerte**, që nuk tretën, nuk ndizen dhe nuk kanë si pasojë reagime fizike ose kimike, që nuk kanë zbërthim biologjik në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
- c. **Mbeturina të vëllimshme**, mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë.
- d. **Mbeturina nga konstruktim-demolimet**, mbeturina të mbetura nga konstruktimi dhe demolimi i objekteve.

2. Mbeturina komerciale quhen mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen në mbeturinat industriale;

3. Mbeturina Industriale quhen mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

4. Mbeturina Medicinale quhen mbeturinat patologjike që krijohen nga aktiviteti medicinal si dhe materialet tjera që përdoren në shërbimet mjekësore.

Neni 9

Taksa mbi mbeturinat

9.1 Taksa mbi mbeturinat, do të faturohet dhe inkasohet nga Komuna prej 01.01. 2016.

9.2 Faturimi i taksës së mbeturinave bëhet në baza vjetore, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave më së largu deri më **28 Shkurt** të vitit kalendarik.

9.3 Gjeneruesi i mbeturinave obligohet të paguaj faturën e taksës së mbeturinave. Pagesën mund ta bëjë edhe me këste dhe atë në katër (4) këste brenda vitit, si më poshtë:

- a. Kësti i parë paguhet më së largu deri më 31 Mars
- b. Kësti i dytë paguhet më së largu deri më 30 Qershor
- c. Kësti i tretë paguhet më së largu deri më 30 Shtator
- d. Kësti i katërt paguhet më së largu deri më 31 Dhjetor

9.4 Pagesa e taksës mbi mbeturinat bëhet në bankë ose filialet e postës.

9.5 Nëse Gjeneruesi i mbeturinave nuk paguan këstet sipas afateve të përcaktuar në Nenin 9, paragrafi 3 i kësaj rregullore nuk do të merr shërbime komunale administrative nga:

- a. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrale dhe Pronë
- b. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- c. Drejtoria për Shërbime Publike Komunale
- d. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- e. Zyra e Prokurimit

9.6 Taksa mujore për mbeturina kategorizohet si më poshtë:

Shkalla e taksës do të rishikohet çdo vit në muajin Shtator nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit dhe i propozohet për miratim Kuvendit Komunal. Prandaj, me aprovimin e shkallës së taksës së përshtatshme për vitin në vijim nga Kuvendi Komunal, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal, dhe tarifa e taksës së miratuar për mbeturina adapton tarifën e mbeturinave të përdorur në vitin aktual siç është bashkangjitur në **shtojcën 1** (shkalla e taksës për mbeturina).

9.7 Me qëllim të ruajtjes së kualitetit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për institucione dhe biznese të mëdha, me të cilat bëhen kontrakte individuale afrohen tarifa minimale të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Neni 10

Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për Shërbimin e Mbeturinave

Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.

Neni 11

Detyrat e inspektorit Komunal

11.1 Inspektori mjedisor komunal dhe inspektori për çështje komunale mbikëqyrin dhe inspektojnë menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës së Rahovecit duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të ligjeve në fuqi.

11.2 Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, inspektorët komunal shqiptojnë dënim mandatorë në shumë prej 5 – 100 € varësisht nga lloji i shkeljes.

Neni 12

Komisioni këshillues

12.1 Drejtoria e Shërbimeve Publike në kuadër të sektorit për menaxhim të mbeturinave themelon Komisionin Këshillues i cili monitoron performancën e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga operatorët e kontraktuar. Ky monitorim do të ndihmon Komisionin Këshillues (i cili ka burime njerëzore të kufizuara) që të promovon sistemin pjesëmarrës të menaxhimit të mbeturinave.

12.2. Komisioni këshillues përbëhet nga 3 deri 7 anëtarë.

12.3 Sektori i menaxhimit të mbeturinave i rekomandon (propozon) anëtarët sipas kritereve të mëposhtme dhe Kryetari i Komunës e miraton.

- Përfaqësues të komunitetit,
- Ekspertë të fushave përkatëse,
- Përfaqësues nga entitetet relevante,
- Qytetarë të zgjedhur mes aplikantëve.

12.4 Detyrat e komisionit këshillues janë:

- a. Të monitoroj shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, ofruar nga operatorët e kontraktuar.
- b. Të përmbledhin opinionet e qytetarëve sa i përket kualitetit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.
- c. Të raportoj për rezultatet e monitorimit dhe opinionet e qytetarëve në takimet e komisionit këshillues të cilat duhet të mbahen.
- d. Të propozoj dhe rekomandoj zgjidhje adekuate Drejtorisë së shërbimeve publike për shërbimin publik për menaxhim të mbeturinave komunale duke përfshirë sistemin e tarifës si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me sistemin për menaxhim të mbeturinave.
- e. Mandati i anëtarëve të komisionit këshillues është dy vjeçar. Në rast të krijimit të vendit të lirë, mandati i zëvendësuesit do të ketë validitetin deri në kohën e mbetur të përfundimit të mandatit të anëtarit paraprak.
- f. Anëtari mund të ri-zgjidhet.
- g. Mëditja bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi të Ligjit për Menaxhimin e Financave Lokale ose akteve nënligjore në fuqi.

12.5 Komisioni këshillues duhet të mbajë takime së paku njëherë në gjashtë muaj, përmbledh gjendjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe e dorëzon raportin (**Raport 6 mujor**) te Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave.

12.6 Sekretaria e Komisionit këshillues është brenda Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave dhe Sektori kryen punët administrative.

Neni 13

Dispozitat Ndëshkuese - Gjobat

13.1 Gjeneruesit që nuk i përmbahet afateve të pagesës së faturave sipas kësaj rregulloreje, ngarkohen me pagimin e borxhit me kamatë ligjore.

13.2. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk e bënë pagesën e tarifës së taksës për mbeturina do të iniciohet procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

13.3 Gjeneruesi i mbeturinave i cili nuk i përmbahet rregullave të shkarkimit, të përcaktuara sipas planit të MMK-së, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 14

Ndalesat

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje ndalohet:

14.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshet apo mjedise publike;

14.2 Hedhja e mbeturinave e llojeve tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë;

14.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, tarracat e banesave etj.);

14.4 Hedhja e mbeturinave në rrugë, trotuare, sheshet apo në mjedise tjera publike;

14.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

14.6 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;

14.7 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;

14.8 Shfrytëzimi i kontejnerëve publikë nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”;

14.9 Gërmimi, përzjerja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë,
ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;

14.10 Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me kontratë apo ndonjë formë tjetër.

14.11 Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.

Neni 15

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

15.1 Të gjitha çështjet - rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në Fuqi,

Neni 16

16.1 Me këtë rregullore të njoftohet, Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Neni 17

Hyrja në fuqi

17.1 Kjo rregullore do të zbatohet nga **01.03.2015**, me përjashtim të neneve **9 dhe 12** zbatimi i të cilave fillon nga **01.01.2016**

17.2 Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdesen: **Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunë të Rahovecit.**


Neni 18

Kjo rregullore hyn në fuqi në afat prej **8 ditësh** nga dita e miratimit nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL.

01 Nr. 239
Rahovec, 30.01.2015

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

Kryesuesi i Kuvendit


Nahit Elshani

 REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odrejenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 299 Më 06.02. 2015
Br. prot. 299 Dt. 06.02. 2015
-III- RAHOVEC - ORAHOVAC

